



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

**KRYETARI I KOMUNËS**

**Nr.02-112/13-79786/20  
Podujevë,  
Më:30.12.2020**

**SHPALLJE PUBLIKE**

**Për angazhimin e punëtorëve me Kontratë për Punë dhe Detyra Specifike  
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)**

Komuna e Podujevës bën Shpallje Publike duke u bazuar në LIGJIN Nr. 03/L-212 të Punës, Neni 10 dhe kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e cila përmes Kontratës për Punë dhe Detyra Specifike kërkon angazhimin e punëtorëve për ofrimin e shërbimeve të nevojshme .

**Kohëzgjatja e Kontratës për Punë dhe Detyra Specifike është 4 (katër) muaj**

**I.Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

**Pozita: Vozitës - Katër (4) pozita**

**Paga: 300 Euro Bruto**

**Kualifikimi: Diplomë e Shkollës së Mesme**

**E domosdoshme: Patentë Shofer - Kategoria B.**

**Përshkrimi i detyrave të punës :**

- Bën transportimin e pacienteve të sëmurë nga QKMF deri ne institucionin me te avansuar(SHSKUK) në bazë të udhëzimit të mjekut ordinar, e në raste urgjente edhe pa udhëzim por me arsyetim të më vonshëm.
- Mirëmbanë automjetin në pikëpamje teknike, eliminon defektet e vogla, ndërsa ato të cilat nuk mundet ti eliminoj vet e lajmëron Udhëheqësin për intervenim të mëtutjeshëm.
- Mban evidencën për kohën e qarkullimit me automjet, kilometrat e kaluara, karburantin e shpenzuar, vajin e të ngjajshme dhe njëherit për punën e vet raporton me shkrim lidhur me shpenzimet e bëra.
- Bën transportimin e punëtorëve shëndetësorë dhe jo shendetësorë gjatë organizimit të punës në teren.
- Kryen edhe punë të tjera në bazë të urdhërit të eprorit.
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

## INFORMATË PËR TË GJITHË APLIKANTËT

### Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- CV
- Certifikatën që ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime
- Kopjen e leternjoftimit
- Kopjen e Dokumentacionit për kualifikimin e kërkuar
- Kopjen e Patentë Shoferit

### Data e shpalljes : 30.12.2020 deri më 03.01.2021

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

